

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 3
03.12.2010

NR. VENDIMI 5
17.05.2011

VENDIM .

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me trup gjykues të përbërë prej gjyqtarëve:

Liljana	BAKU	Kryetare
Bardhyl	Dhama	Anëtar
Iliriana	OLLDASHI	Anëtare

Asistuar nga sekretare seance **Andina KAJA**, sot në datë 17.05.2011, përfundoi në seancë gjyqësore publike, gjykimin e kërkesës Nr 3/17 Rregjistri që i përket palëve:

KËRKUES:

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, përfaqësuar nga prokurori **B. M. .**

KUNDËR

SHTETASIT NËN HETIM

O. S., i biri i **B.** dhe i **V. .**, i datëlindjes xx.xx.xxxx, lindur dhe banues në xxxxxxxx Lagjja “xxxxxxxxxx x xxxxxxxx”, Pallati Nr. xx, mbrojtur nga mbrojtësi i caktuar kryesisht nga gjykata, Av. P. L me Nr. Liçense xxx, Nr. Nipti K XXXXXXXXXXXX K, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë.

OBJEKTI:

Konfiskimi i pasurisë:

Llogari bankare, në shumën 30 000 Euro, çelur pranë Bankës Kombëtare Tregëtare në datë 23.07.2009, me Nr. XXXXXXXX, në emër të shtetasit **O. B. S.**

BAZA LIGJORE:

Ligji Nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Gjykata, në përfundim të gjykimin, zhvilluar në mungesë të shtetasit nën hetim O. S , duke qenë kompetente për të gjykuar dhe vendosur në bazë të nenit 7 pika 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009, pasi shqyrtoi provat e paraqitura dhe të marra në gjykim, dëgjoi pretendimet përfundimtare të palëve në të cilat u kërkua:

Prokurori B. M. : Pranimin e kërkesës, konfiskimin e llogarisë bankare, çelur pranë Bankës Kombëtare Tregëtare, në datë 23.07.2009, në shumën 30 000 Euro, në emër të shtetasit O. S. Për administrimin dhe përdorimin e pasurisë së konfiskuara të ngarkohet Z. S. M. , administrator i Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë dhe, për ekzekutimin e vendimit Zyra e Përmbartimit Tiranë.

Mbrojtësi i caktuar kryesisht nga gjykata, Av. P. L : Mospranimin e kërkesës me objekt konfiskimin e llogarisë bankare, si kërkesë e ngritur kundër një personi ndaj të cilit nuk mund të ngrihej dhe, pushimin e gjykimin të çështjes.

V Ë R E N

Në datë 11.02.2010, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka rregjistruar procedimin penal Nr. 659 viti 2010, për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Rregjistrimi i këtij procedimi është bërë mbi bazën e informacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave mbi një rast të dyshimtë, të pastrimit të produkteve të veprës penale, nga shtetasit shqiptarë E. dhe E. Z. , L. B. , O. S. , M. K. dhe S. C.

Nga aktet bashkëngjitur informacionit ka rezultuar se, këta shtetas janë duke u hetuar nga Prokuroria e Athinës, për shkelje të neneve 45, 94, 322 dhe 385 të Kodit Penal Grek që kanë të bëjnë me pengmarrje, kërcënim në bashkëpunim dhe armëmbajtje pa leje. Veprat penale për të cilat hetohen janë kryer prej tyre në periudhën kohore 19.06.2009 - 25.06.2009 dhe kanë të bëjnë me rrëmbimin e shtetas greke E. A. F., kërcënimin e shtetasit grek A. S.Th. , mik i të dëmtuarës, që ka bërë pagesën në kesh të shumës prej 1.800.000 euro, me qëllim lirim të saj.

Në datë 03.05.2010, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, ka rregjistruar procedimin pasuror në ngarkim të shtetasit nën hetim O. B.S. , duke qenë ai rrjedhojë e procedimit penal të filluar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Nga materiali hetimor që Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë i ka dërguar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë ka rezultuar se, nëpërmjet Oficerit të Kontaktit në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Athinë, është përcjellë në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit Shkresa Nr. 1047/3/250/2-p4a datë 02.02.2010 e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit të Greqisë, mbi ndalimin e disa shtetasve shqiptarë. Nga përmbajtja e saj ka rezultuar se kjo e fundit (Drejtoria e Policisë

Greke) ka referuar pranë Prokurorisë së Athinës nisjen e procedimit penal në ngarkim të tetë të akuzuarve (prej të cilëve gjashtë shtetas shqiptarë), për shkelje të neneve 45, 94, 322 dhe 385 të Kodit Penal Grek, në lidhje me rrëmbimin e shtetases greke E. F. Ndërmjet shtetasve për të cilët është urdhëruar ndalimi rezulton edhe shtetasi O. S., për të cilin është shpallur kërkimi ndërkombëtar.

Në kuadër të hetimit, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka kërkuar informacion nga bankat e nivelit të dytë, që operojnë në Republikën e Shqipërisë, për llogari bankare të mundshme në emër të shtetasit O. S.

Nga informacionet e marra nga bankat e nivelit të dytë ka rezultuar se shtetasi O. S. ka hapur dy llogari bankare. Sipas shkresës Nr. . 988/1 datë 25.02.2010 të Bankës Kombëtare Tregëtare shtetasi O. S. është disponues i një llogarie bankare pranë kësaj banke në shumën 30.000 Euro (tridhjetmijë). Sipas Shkresës Nr. 277 datë 23.02.2010 të UNION BANK shtetasi O. S. ka patur një llogari bankare pranë kësaj banke, në shumën 100.000 Euro (njëqindmijë) , të çelur në datë 30.06.2009 dhe të mbyllur në datë 03.02.2010.

Mbi kërkesën e prokurorisë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me Vendimin e saj Nr. 595 akti datë 29.03.2009 ka vendosur sekuestro preventive mbi llogarinë bankare pranë Bankës Kombëtare Tregëtare të shtetasit O. S.

Nisur nga fakti që shtetasi O. S. dhe familjarët e tij nuk kanë ndonjë aktivitet tregëtar të rregjistruar dhe, se ai në momentin e çeljes së depozitës ka deklaruar si burim të ardhurash emigracionin, prokuroria ka ngritur dyshimin e arsyeshëm, të bazuar në prova (sipas saj) për kryerje prej tij të veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Gjithashtu, duke çmuar se ndodhet para rasteve të parashikuara nga Ligji Nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, materialin hetimor ja ka kaluar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

Mbi kërkesën e Prokurorisë pranë saj, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me Vendimin Nr. 7 datë 11.06.2010, bazuar në nenin 11 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009, ka vendosur masën parandaluese të sekuestros mbi pasurinë objekt konfiskimi. Vendimi nuk është ankimuar.

Në vendosjen e sekuestros (shih vendimin e mësipërm) gjykata ka arsyetuar qënien e shtetasit O. S. subjekt i zbatimit të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009, në referim të nenit 3 pika 1 gërma “d” të tij. Është konstatuar prej saj ekzistenca e kriterëve të përgjithshme për vendosjen e masës së sekuestros të cilat lidhen me ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në indicje për pjesmarrje të shtetasit O. në veprimtari kriminale që përfshihet në fushën e zbatimit të këtij ligji si dhe, e zotërimit prej tij të një pasurie që nuk i përgjigjet dukshëm nivelit të të ardhurave (të parashikuara si të tilla në nenin 11 pika “a” dhe “b” të Ligjit në fjalë). Gjithashtu, është arsyetuar edhe ekzistenca e kriterit të veçantë i lidhur me rrezikun e tjetërsimit apo humbjes së pasurisë (e parashikuar në gërmën “a” të pikës 1 të nenit

11 të Ligjit).

Në datë 03.12.2010 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, bazuar në nenin 21 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009, ka paraqitur para kësaj gjykate kërkesën me objekt konfiskimin e pasurisë së përshkruar në pjesën hyrëse të vendimit.

Gjykimi i kërkesës me objekt konfiskimi u zhvillua në mungesë të shtetasit nën hetim O. S. .Për njoftimin e tij gjykata, në bazë të parashikimit të pikës 1 të nenit 22 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009, sipas të cilit “*Gjatë gjykimit të kërkesës për konfiskim zbatohen, për aq sa është e mundur, dispozitat e Kodit të Procedurës Civile*”, aplikoi njëkohësisht dispozitat e këtij Kodi dhe të Ligjit në fjalë.

Në seancën gjyqësore të datës 21.12.2010 njoftimi i shtetasit O. S. ishte kryer nëpërmjet letërthirrjes (ashtu sikurse e parashikon neni 128 i Kodit të Procedurës Civile) ,dërguar në rrugë postare e cila, në bazë të nenit 131 paragrafi 2 i këtij Kodi, i ishte dorëzuar babait të tij, shtetasit B. S. Për më tepër ky i fundit (pra babai), së bashku me Av. S.V , u paraqit personalisht në këtë seancë gjyqësore duke deklaruar përpilimin, për seancën pasardhëse të gjykimit, të një prokure të posaçme, nga djali i tij O. S.

Në seancën gjyqësore të datës 05.01.2011, pavarësisht disponimit të letërthirrjes për njoftimin e shtetasit O. S. , të nënshkruar nga babai i tij, shtetasi B. S. , me shënimin “*Marr përsipër njoftimin*”, gjykata e çmoi të nevojshme të aplikonte nenin 22 pika 2 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009, sipas të cilit “*Me kërkesë të prokurorit gjykata mund të vazhdojë gjykimin edhe në rastet kur personi nuk ka banim të njohur brenda vendit, është larguar jashtë vendit ose, me gjithë kërkimet e bëra, nuk gjendet. Në këtë rast gjykata vendos mosgjetjen e personit duke i caktuar atij një avokat. Avokati mund të caktohet kryesisht nga gjykata ose të zgjidhet nga të afërmit e personit*”.

Në zbatim të dispozitës së përshkruar më sipër, gjykata urdhëroi policinë gjyqësore, në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Elbasan, për të bërë të gjitha kërkimet e nevojshme për gjetjen dhe njoftimin e shtetasit O. S. Pas një sërë shkresash të mbërritura jashtë afatit ligjor, bazuar në Shkresën Nr. 1629/1 Prot datë 24.03.2011 të Komisarariatit të Policisë, në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Elbasan, sipas të cilës shtetasi i sipërpërmendur **ndodhej i larguar jashtë shtetit në Greqi** gjykata, bazuar në nenin 22 pika 2 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009 vendosi mosgjetjen e tij dhe caktimin e mbrojtësit kryesisht, Av. P. L.

Në pikën 3 të nenit 21 të Ligjit është parashikuar detyrimi që ka personi, pasuria e të cilit kërkohet të konfiskohet, për të paraqitur prova në gjykim në funksion të provueshmërisë së prejardhjes së ligjshme të pasurisë objekt konfiskimi: “*Barra e provës, për të fituar se pasuritë janë fituar në mënyrë të ligjshme, i përket personit, kundër pasurive të të cilit kërkohet konfiskimi*”.

Gjatë gjykimit, mbrojtësi i caktuar kryesisht nga gjykata, nuk j'u përmbajt detyrimit ligjor të parashikuar më sipër. Ai nuk paraqiti dhe nuk kërkoi marrjen e provave të cilat do t'i shë.in për të provuar se llogaria bankare, e çelur nga shtetasi nën hetim O. S. , në Bankën Kombëtare Tregëtare ishte produkt i një veprimtarie të ligjshme të kryer prej tij. I vetmi pretendim i ngritur prej tij në gjykim kishte të bëntë me dyshimet në identitetin e shtetasit në hetim. Konkretisht sipas tij, nga informacionet e marra nga autoritet greke, bëhet fjale për shtetasin O. B. S., pra për një shtetas me emër babai "B." dhe jo për shtetasin O. B. S. Mbi bazën e këtij pretendimi për mbrojtësin kërkesa për konfiskim duhej të konsiderohej si e ngritur ndaj një personi ndaj të cilit nuk mund të ngrihej.

Për të kundërshtuar pretendimin e mbrojtësit, në kushtet e riçeljes së hetimit gjyqësor (bazuar kjo në nenin 304 të Kodit të Procedurës Civile), prokurori paraqiti akte shtesë të cilat konsistonin në:

1. Urdhër arresti ndërkombëtar, lëshuar nga autoriteti gjyqësor në Athinë për shtetasin shqiptar O. S., i transmetuar nga Interpol Tirana me Shkresën Nr. 274/8 datë 26.05.2010. Në të dhënat personale për këtë shtetas si emër babai përmendet emri "B."
2. Shkresa Nr. 8964/1 Prot datë 19.03.2010 e Ministrisë së Brendshme, drejtuar Zv/Drejtorit të Përgjithshme Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit Tiranë, sipas të cilës në Rregjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile figuron i rregjistruar vetëm një shtetas me gjeneralitetet O. S.

Në përfundim të gjykimit **prokurori B. M.** paraqiti pretendimet dhe kërkimet përfundimtare. Sipas tij:

Llogaria bankare në emër të shtetasit nën hetim O. S. , çelur në Bankën Kombëtare Tregëtare, në shumën 30 000 Euro, është pasuri e krijuar pas përfshirjes së tij në aktivitetin kriminal të zhvilluar në periudhën 19.06.2009 - 25.06.2009. Nga mbrojtësi i shtetasit nën hetim, në seancë gjyqësore, nuk u sollën prova për të vërtetuar ligjshmërinë e saj. **Mbi bazën e këtij pretendimi u kërkua përfundimisht konfiskimi i llogarisë bankare si pasuri me prejardhje jo të ligjshme.**

Mbrojtësi i caktuar kryesisht nga gjykata, **Av P. L** , paraqiti pretendimet dhe kërkimet përfundimtare. Sipas tij identiteti i shtetasit nën hetim O. S. mbetet i dyshimtë. **Mbi këtë pretendim ai kërkoi pushimin e gjykimit të çështjes.**

Gjykata, në analizë të provave të paraqitura dhe marra në gjykim, konkludon se kërkesa e prokurorit për konfiskimin e llogarisë bankare, në zotërim të shtetasit nën hetim O. S. është e drejtë, e bazuar në ligj dhe si e tillë duhet të pranohet.

Në pikën 1 të nenit 24 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen kundër krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë" parashikohet shprehimisht:

“Gjykata vendos konfiskimin e pasurive kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) kur ka dyshime të arsyeshme, bazuar në indicje, për pjesmarrjen e personit në veprimtari kriminale të parashikuara në nenin 3 të këtij ligji;

b) kur nuk provohet se pasuria ka prejardhje të ligjshme, apo personi nuk justifikon zotërimin e pasurive ose të të ardhurave, që nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruara dhe as nuk justifikohen prej tyre; dhe

c) kur rezulton se pasuria është drejtdrejt ose tërthorazi në zotërim të pjesshëm apo të plotë të personit”.

Në interpretim dhe zbatim të kësaj dispozite Gjykata çmon se për vendosjen e masës parandaluese të konfiskimit, është e domosdoshme vërtetimi i ekzistencës njëkohësisht të tre kushteve që kanë të bëjnë: **1.** Me ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, bazuar në indicje për pjesmarrje në veprimtari kriminale të parashikuara në nenin 3 të Ligjit, i cili bën fjalë për fushën e zbatimit të tij; **2.** Me prejardhjen e paligjshme të pasurisë apo mosjustifikimin e zotërimin të saj, referuar nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të tjera të ligjshme të deklaruara dhe **3.** Me zotërimin e plotë apo të pjesshëm të pasurisë nga personi i proceduar drejtpërdrejt apo tërthorazi.

Në përfundim të gjykimit të kërkesës me objekt konfiskimin e llogarisë bankare, në zotërim të shtetasit nën hetim O. S. , mbi bazën e provave të paraqitura në të në kushtet e debatit gjyqësor, gjykata çmoi ekzistencën njëkohësisht të tre kushteve të sipërpërmendura për vendosjen e kësaj mase parandaluese.

Së pari: Ashtu sikurse është arsyetuar në Vendimin Nr. 7 datë 11.06.2010 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me të cilin është vendosur masa e sekuestros mbi pasurinë objekt konfiskimi, **mbi shtetasin O. S. rëndon dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në indicje, për pjesmarrje në veprimtarinë kriminale të pastrimit të produkteve të veprës penale.**

Shtetasi O. S. është duke u proceduar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar si e tillë në nenin 287 të Kodit Penal, e cila përfshihet në rrethin e veprave penale të fushës së zbatimit të Ligjit (neni 3 pika 1 gërma “d” të tij). Ky procedim ka filluar mbi bazën e informacionit për pjesmarrje të shtetasit shqiptar O. S. në rrëmbimin e një shtetase greke, të kryer në Greqi, për lirim të të cilës është paguar shuma 1 800 000 Euro.

Çelja nga shtetasi i dyshuar O. S. i dy llogarive bankare, në periudhën pas aktivitetit kriminal të kryer në Greqi, njëra objekt konfiskimi, në shumën 30 000 Euro në Bankën Kombëtare Tregëtare dhe tjetra në Union Bank (e çelur në datë 30.06.2009 dhe e mbyllur në datë 03.02.2010); Deklarimi i burimit të tyre si “E ardhur nga emigracioni”; Mungesa e aktiviteteve tregëtare në emër të tij dhe familjarëve; Mungesa e deklarimit për para kesh në momentin e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë; mosha e re dhe çelja e llogarive në periudhën pas Qershorit 2009 vazhdojnë të konsiderohen nga gjykata si indicje të rëndësishme, mbi të cilat qëndron dyshimi i arsyeshëm për pjesmarrje të shtetasit O. S. në veprimtarinë kriminale të pastrimit të produkteve të veprës penale, si objekt parandalimi i ligjit në fjalë.

Së dyti: Nga ana e mbrojtësit të caktuar kryesisht nga gjykata, në kushtet e gjykimit në mungesë të shtetasit nën hetim O. S. , nuk u sollën prova në funksion të

provueshmërisë së prejardhjes së ligjshme të pasurisë objekt konfiskimi. Në bazë të ligjit barra e provës i përket shtetasit nën hetim O. S. dhe në mungesë të tij mbrojtësit të caktuar kryesisht nga gjykata. Duke mos sjellë prova në gjykim, mbrojtësi nuk përmbushi detyrimin ligjor që parashikon Ligji (i trajtuar më sipër) duke u interpretuar kjo rrethanë në funksion të mungesës së prejardhjes së ligjshme të pronës objekt konfiskimi.

Së treti: Pasuria objekt konfiskimi është nën zotërimin e drejtpërdrejtë të shtetasit nën hetim O. S. Llogaria bankare në shumën prej 30 000 Euro është çelur në Bankën Kombëtare Tregëtare, në datë 23.07.2009, nga shtetasi nën hetim O. S. dhe ka si mbajtës të vetëm të saj pikërisht këtë shtetas.

Mbi bazën e argumentimit të mësipërm të ekzistencës së tre kushteve të vendosjes së masës parandaluese të konfiskimit Gjykata, bazuar në nenin 24 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen kundër krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, çmon se kërkesa e prokurorisë me objekt konfiskimin e llogarisë bankare në emër të shtetasit O. S., çelur në Bankën Kombëtare Tregëtare, duhet të pranohet.

Pretendimi i mbrojtësit mbi dyshime në identitetin e shtetasit nën hetim O. S. mbetet i pabazuar. Nga provat e paraqitura nga pala kërkuese u provua se shtetasi për të cilin ekzistojnë dyshime të bazuara në indicje për pjesëmarrje në veprimtarinë kriminale të pastrimit të produkteve të veprës penale është shtetasi O. S., i biri i B. dhe i V. , me banim në qytetin e Elbasanit. Është pikërisht ky shtetas, me këto gjeneralitete, për të cilin është shpallur kërkim ndërkombëtar nga autoriteti i drejtësisë greke. Nga verifikimet e kryera në Rregjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile nuk ka rezultuar shtetas tjetër i regjistruar me emrin O. S.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, bazuar në nenet 24 pika 1, 25, 26 e 28 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen kundër krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, 306, 310, 443 dhe 444 të Kodit të Procedurës Civile.

V E N D O S I

Pranimin e kërkesës.

Konfiskimin dhe kalimin në favor të shtetit të pasurisë, Llogari Bankare, në 30 000 Euro, çelur pranë Bankës Kombëtare Tregëtare në datë 23.07.2009, me Nr. XXXXXXXXXX, **në emër të shtetasit O. B. S.**

Për ekzekutimin e vendimit ngarkohet Zyrat e Përmbarrimit në Tiranë dhe, administrimin e saj Z.S. M , administrator në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, pranë Ministrisë së Financave Tiranë.

Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen shtetasit nën hetim O. B. S.

Kundër vendimit lejohet e drejta e ankimit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e shpalljes dhe, për shtetasin O. S. në mungesë nga dita e njoftimit të vendimit, në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

U shpall në Tiranë, sot në datë 17.05.2011.

SEKRETARE

ANDINA KAJA

GJYQTARE

LILJANA BAKU